



# INFORMACIONE

## QERSHOR - GUSHT 2005

### KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

*Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Alfred Moisiu dhe Kryebashkiaku i Tiranës z. Edi Rama presin Medalistët në "Almeria 2005".*

Në nder të suksesit të sportistëve shqiptarë në Lojrat Mesdhetare "Almeria 2005", në 20 Korrik Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Alfred Moisiu priti në Presidencë delegacionin e kryesuar nga Presidenti i KOKSH, z. Hysen Domi, Sekretari i Përgjithshëm z. Stavri Bello, Shefi i Misionit z. Fidel Ylli dhe fituesit e medaljeve në këto lojra, Ilirjan Suli, Fetie Kasaj, Romela Begaj dhe Gert Trasha në sportin e Peshëngritjes dhe Klodiana Shala në sportin e Atletikës, të pranishëm ishin edhe trainerët e tyre Hektor Shaqiri, Ilir Çela dhe Taulant Stërmasi. Përveç urimeve të rastit nga Presidenti i Republikës z. Moisiu ata diskutuan çështje në fushën e sportit në mënyrë që shteti të ketë një vëmendje të veçantë dhe të mbështesi sportistët elitare. Nga



**Nga takimi me Presidentin e Republikës, A. Moisiu**

ana e tij Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Alfred Moisiu premtoi gadishmërinë dhe angazhimin e tij në drejtim të përmirësimit të ligjit të sportit në lidhje me mbështetjen e sportistëve elitare.



**Me kryebashkiakun Edi Rama**

Gjithashtu delegacioni më datë 22 Korrik u prit edhe nga Kryebashkiaku i Tiranës, z. Edi Rama. Në emër të Bashkisë së Tiranës, Kryetari i saj z. Rama uroi sportistët për medaljet e fituara në Lojrat Mesdhetare "Almeria 2005" dhe premtoi se do të jetë mbështetës në programin 2005-2008 të përgatitjes së sportistëve "për Pekin 2008"

### 3 Qershor Dita Olimpikë Vrapimit – Elbasan

Dita Olimpikë e Vrapimit këtë vit u zhvillua edhe në qytetin e Elbasanit në komunën e Gjinarit. Pjesmarrja e të rinjëve në veprimtaritë sportive-kulturore, bën të mundur edukimin e tyre me vlerat e idealeve Olimpikë. Dita Olimpikë e Vrapimit "Bukanik 2005" ishte tepër e larmishme në përmbajtje dhe pjesmarrje. Aktiviteti i cili promovonte paqen, fair play, miqësinë e gëzimin u ndoq dhe u zhvillua nën kujdesin e Komitetit Olimpik Rajonal Elbasan, Komunës së Gjinarit, Bashkisë Elbasan dhe u mbështet nga KOKSH.

## 8 Qershor Mbledhje e Komitetit Organizator te Kampionatit Europian i Mundjes (Kadet).

Përfaqësuesit më të lartë të Federatës Botërore dhe Europiane të Mundjes dhe Komiteti organizator i Kampionatit Europian të Mundjes zhvilluan një takim pune në ambjentet e KOKSH. Rendi i ditës ishte mbi masat e marra nga organizatorët dhe çështje për tu zgjidhur. Pas mbledhjes, përfaqësuesit e FILAs dolën në një konferencë për shtyp ku konfirmuan arritjet për organizimin e këtij aktiviteti dhe u shprehën se ky aktivitet do të jetë një sukses i vërtetë dhe pjesmarrja e më shumë se 600 sportitëve e konfirmon këtë më së miri.



Komiteti Organizator të Kampionatit Europian të Mundjes

## 9 Qershor – KOKSH promovon Vullnetarizmin.

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH ka qënë në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja për të promovuar vullnetarizmin tek të rinjtë në kuadër të përfshirjes së vullnetarëve në Kampionatin Europian të Mundjes për të rinjë e të reja që u zhvillua në Tiranë në datat 12-17 Korrik. - “Vullnetarizmi është një nga vlerat dhe aspektet shumë të rëndësishme që

karacterizon një shoqëri në një qytetërim, prandaj ju ftoj edhe ju të jeni pjesë e saj”, u shpreh z. Bello në fund të takimit. Shkolla e Mesme e gjuheve të huaja, prej kohësh ka kontribuar me nxenesit e saj në suksesin e evenimenteve nderkombetare sportive që komuniteti Sportiv ka organizuar në Shqipëri.

### 15 Qershor – “Almeria 2005” Takim informues në KOKSH

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello dhe Shefi i Misionit z. Fidel Ylli, në ambjentet e KOKSH kanë zhvilluar takim informues me të gjithë Sportistët dhe trainerët pjesëmarrës në Lojrat Mesdhetare “Almeria 2005”. Në takim pjesmarrësit janë pajisur me programin e grumbullimit dhe kalendarin e garave për secilin sport.

### 24 Qershor Lojrat Mesdhetare “Almeria 2005” - Ceremonia e Hapjes

“Almeria 2005” - Edicioni i 15-të i Lojrave Mesdhetare u shpall zyrtarisht i hapur të Premten e 24 Qershorit 2005 nga Mbreti i Spanjës Juan Carlos. Ndërmjet 21 vendeve, Shqipëria do të përfaqësohet në këto disiplina sportive: Atletikë, Boks, Karate, Mundje, Qitje, Not, Volejball, Gjimnastikë, Ping-Pong, Peshëngritje dhe Rowing.

### 18 Qershor – Konferencë për shtyp “Almeria 2005”.

Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe Shefi i Misionit të KOKSH, informuan se tashmë delegacioni pjesmarrës në Lojrat Mesdhetare “Almeria 2005” është i kompletuar dhe se janë marrë të gjitha masat për vajtjen në Almeria, Spanjë. Kompania e Telefonise Celulare AMC, e cila u tregua e gatëshme të ishte sponsor i uniformave sportive të Skuadrës Shqiptare pjesmarrëse në “Almeria 2005”, u falënderua nga Sekretari i Përgjithshëm z. Bello në emër të KOKSH.







**Sportistët pjesëmarrës në Festivalin Olimpik Rinor European, "Lignano 2005"**

### 2-8 Korrik EYOF-"Lignano 2005", Shqipëria në Festivalin Olimpik Rinor European në Lignano

Në Sabbiadoro të Italisë, në datat 2-8 Korrik, u zhvillua Festivali Olimpik Rinor European "Lignano 2005". Ky eveniment i rëndësishëm Olimpik mbledhi sëbashku të rinjë e të reja nga 48 vënde të Europës. Nën drejtimin e zv/Presidentes së KOKSH znj. Ela Tase, Delegacioni Shqiptar me një skuadër modeste u përfaqësua në 4 disiplina sportive: atletikë, çiklizëm, not dhe xhudo. Pjesëmarrësit në « Lignano 2005 » :

**Ela Tase – Shef Misioni**

Traineret	Sportistët	Sporti	Disiplina	Rezultatiet
Vladimir Fëngjilli	Olgerta Gjylapi Eraldo Xhiveshi	Atletikë	100m K. së gjati	12.97s 6.77 m
Nikollaq Hysi	Leoard Zeneli	Çiklizëm	Kronometri individual 7.4 km	10'02.07
Bashkim Aliraj	Malbor Oshafi	Not	50 stil i lire 100 200 400	27.06 58.60 2'09.75 4'33.04
Labo Çapo	Arbër Syla	Xhudo	Pesha +90kg	humbet në eliminatore

### 12-17 Korrik Kampionati European i Mundjes për Kadet (të rinjë e të reja)

Në Tiranë në datat 12-17 Korrik 2005, në pallatin e sportit "Asllan Rusi" u zhvillua kampionati European i Mundjes për Kadetë. Një maraton e vërtetë ishte ky aktivitet ku me pjesëmarrjen e 43 vendeve të Europës për një javë rresht konkuruan në të dy stilet atë Greko-Romak dhe të Lirë më se 600 sportistë. KOKSH ofroi mbështetjen e tij në organizimin e këtij kampionati duke angazhuar të gjithë stafin e tij. FILA-Federata Ndërkombëtare e Mundjes, për organizimin me sukses të aktivitetit i dhuroi Presidentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të KOKSH medaljen e arit të FILA-s.



Gjatë ceremonisë së dhënies së medaljeve

# Sportistët medalistë



Emri Ilirian  
Mbiemri Suli  
Datëlindja 11/10/1975  
Gjatësia 171 cm  
Pesha 85 kg  
Sporti Peshëngritje  
Kariera sportive 17 vjet

**Rezultate në aktivitete ndërkombëtare:**

Medalje Argjendi

Vendi 5-te

Medalje Argjendi

Medalje Argj. + Bronzi

Kampionati European, viti 2000  
Lojrat Olimpikë "Sidney 2000"  
Kampionati Botëror për të rritur,  
viti 2002 Warsshave-Poloni  
Lojrat Mesdhetare « Almeria  
2005 »



Emri Fetije  
Mbiemri Kasaj  
Datëlindja 28/10/1985  
Gjatësia 160 cm  
Pesha 53 kg  
Sporti Peshëngritje  
Kariera sportive 6 vjet

**Rezultate në aktivitete ndërkombëtare:**

2 Med.Argj + 1 Bronzi

Medalje Argjendi

Medalje Argjendi

Kampionati European për të reja  
Burgas-Bullgari 2004  
Kampionati Botëror për të reja  
Busan-Kore 2005  
Lojrat Mesdhetare "Almeria  
2005"



Sponsor i Setit e  
uniformave sportive  
të Skuadrës  
Shqiptare në  
"Almeria 2005"

Sporti	Emri	Data e Konk
<b>Peshëngritje</b>	Ilirian SULI	E Merkure, 29.
	Ilirian SULI	E Merkure, 29.
	Fetie KASAJ	E Diele, 26.06.
	Romela BEGAJ	E Hene, 27.60.
	Gert TRASHA	E Diele, 26.06.
<b>Atletikë</b>	Klodiana SHALA	E Premte, 01.0



Emri Romela  
Mbiemri Begaj  
Datëlindja 02/11/1986  
Gjatësia 162 cm  
Pesha 58 kg  
Sporti Peshëngritje  
Kariera sportive 1 vit

**Rezultate në aktivitete ndërkombëtare:**

Medalje Bronzi

Lojrat Mesdhetare  
"Almeria 2005"

# në “Almeria 2005”

Numri i urimit	Disiplina	Medalje
06.05	85 kg Shkeputje(M)	ARGJEND
06.05	85 kg Shtytje(M)	BRONZ
05	53 kg Shtytje(F)	ARGJEND
05	58 kg Shkeputje (F)	BRONZ
05	62 kg Shtytje (M)	BRONZ
07.05	400m (F)	BRONZ



Emri Klodiana Shala  
 Mbiemri Shala  
 Datëlindja 22/08/1979  
 Gjatësia 168 cm  
 Pesha 48 kg  
 Disiplina Atletikë,  
 400m/p, 400m, 200m  
 Kariera sportive 15 vjet

**Rezultate në aktivitete ndërkombëtare:**

- Medalje Argjendi      Kampionati Ballkanik salla të mbyllura, viti 2004 Athinë
- Medalje Bronzi      Kampionati Ballkanik të rritur, viti 2004 Stamboll
- Medalje Bronzi      Lojrat Mesdhetare « Almeria 2005 »
- Medalje Ari          Kampionati Ballkanik, viti 2005 Novi Sad



Emri Gerti Trasha  
 Mbiemri Trasha  
 Datëlindja 31/01/1988  
 Gjatësia 160 cm  
 Pesha 62 kg  
 Sporti Peshëngritje  
 Kariera sportive 6 vjet

**Rezultate në aktivitete ndërkombëtare:**

- Medalje Bronzi      Kampionati European U17, viti 2002 Nice-France
- Medalje Ari          Kampionati European për të rinj, viti 2003 Gjermani
- 1 Medalje Ari + 2 Argj.      Kampionati U17, viti 2004 Stavanger-Norvegji
- Medalje Bronzi      Lojrat Mesdhetare « Almeria 2005 »

## 20 Korrik - Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH

Komiteti Ekzekutiv i KOKSH, nën drejtimin e Presidentit z. Hysen Domi , zhvilloi mbledhjen e radhës me rend dite:

- Raport mbi Lojrat Mesdhetare “Almeria 2005”
- Raport mbi EYOF - Festivali Olimpik Rinor European “Lignano 2005”.

Në takim Presidenti Domi falenderoi anëtarët e K.E. për ndjekjen nga afër të aktiviteteve shumë të rëndësishme që KOKSH ka pasur në këtë periudhë dhe në mënyrë të veçantë për kurorëzimin me sukses të misionit të tyre uroi Shefin e Misionit të « Almeria 2005 », z. Fidel Ylli dhe Shefin e Misionit të « Lignano 2005 », znj. Ela Tase.



# Almeria



Delegacioni Shqiptar gjatë ceremonisë së hapjes



Nga jeta sociale në Fshatin Olimpik



Trajneri Mara dhe sportistja Çuko



Skuadra Shqiptare e Volejbollit - meshkuj



Maskoti zyrtar i "Almeria 2005"



Nga gara e sportit "Rowing"



# 2005



Krijuar nga nxënësit e shkollave për skuadrën shqiptare



Skuadra e Volejbollit për Femra, gjatë një pushimi



Qitësit shqiptarë



Karateisti Latifi gjatë garës



Shefi i Misionit, Fidel Ylli duke inkurajuar sportistët



Boksieri shqiptar në garë



Peshngritsi shqiptar i inkuadruar në ekran

## 6 Korrik "Londra 2012" fiton kandidaturën për Lojrat Olimpikë

Pas një "luftë" të ashpër e të nxehtë të qyteteve kandidate për Lojrat Olimpikë 2012 Moska, Parisi, Londra, Madridi dhe Nju Jorku, në datë 6 Korrik në ishullin e Singaporit, të gjithë sytë e veshët e sportdashësve, mediave, por edhe politikanëve të shquar ishin fokusuar në mbledhjen e CIO ku do të zhvillohej edhe votimi për qytetin fitues që do të jetë pritsja e Lojrave Olimpikë 2012. Pas disa vlerësimeve të bëra Londra dhe Parisi ishin pretendentët kryesorë, por nga një votim i



fshehtë kandidatura e "London 2012" fitoi të drejtën e organizimit të Lojrave Olimpikë duke siguruar disa vota më shumë se "Paris 2012".

## Pasqyrimi i aktiviteteve të federatave Sportive Shqiptare



Nga Kampionati Ballkanik i Beach Volley, Golem

### 18 - 20 Gusht, Kampionati Ballkanik i Beach Volley

Federata Shqiptare e Beach Volley në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Volejbollit, organizuan në datat 18 - 20 Gusht, Kampionatin Ballkanik të Beach Volley. Në këtë aktivitet morën pjesë ekipet e Rumanisë, Greqisë dhe Turqisë, ndërsa Shqipëria u përfaqësua me tetë çifte, 4 vajza e 4 djem. Ky aktivitet u zhvillua në plazhin e Golemit ku u ndoq me interes nga turistët e shumtë.

### Kampionati i 10-të Ballkanik i Karatesë

Në datat 10 - 11 në Pallatin e Sportit Asllan Rusi, u organizua Kampionati i 10-të Ballkanik i Karatesë për kadetë dhe juniorë. Hera e parë që organizohet një aktivitet i këtij niveli për këtë sport. Skuadra Shqiptare e Karatesë u përfaqësua në të gjithë kategoritë e peshave me një ekip të plotë, e cila arriti të fitojë me meritë një medalje ari, katër argjendi dhe pesë bronxi, gjithashtu në ekipore për vajza medalje bronxi. Ky aktivitet u zhvillua gjatë dy ditëve dhe në ditën e dytë u zhvillua dhe Kongresi Ballkanik i Karatesë të cilën e drejtoi Presidenti i FBK-së Z. George Jorolimpos.



Skuadra Shqiptare e Karatesë



### KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

President: Hysen Domi  
Sek i Përgjithshëm: Stavri Bello

Rruga: "Muhamet Gjollësia", 21 Dhjetori -  
Tel. +355 235249/240602 - Fax.+355 240565  
E-mail:secretariat@nocalbania.org.al - www.nocalbania.org.al